



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 57/12
Prishtinë, më 4.04.2012, ora 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Muhamet Mustafa.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Gani Gërguri Guvernator i BQK-së (me stafin e tij), Jose Sulejman Shef i Zyrës së FMN-së në Kosovë, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-93 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare

Kryetarja, njoftoj anëtarët e komisionit se ka pranuar edhe disa rekomandime nga OJQ-ve BIRN, të cilat i keni përpara, për plotësimet shtesë në dispozitat e projektligjit. Lidhur me këto propozime kam pasur biseduar me ministrin e financave, me guvernatorin dhe me FMN. Kam kerku nga sponsorizuesit e projektligjit dhe BQK-ja të analizojnë këto rekomandime dhe të japin komentet për secilin propozim, për çka edhe BQK-ja ka bërë komentet, të cilat edhe i keni. OJQ-BIRN ka shpreh shqetësimin se nëse lejohet mundësia që nga institucioni mikrofinanciar të krijohet një shoqëri aksionare, atëherë ekziston rreziku që donatori nuk përkrah më OJQ-të. Prandaj me qëllim që të heqen dilemat se me këtë projektligj nuk rregullohen dhe preken OJQ-të që nuk janë mikrofinanca me dispozita të përgjithshme në kapitullin 2 është një rekomandim nga BQK në fund të paragrafit të plotësohet dhe të thuhet: Organizatat jo qeveritare që kryejnë aktivitete tjera jo financiare nuk janë subjekt i këtij ligji.

Hykmete Bajrami, theksoi se edhe rekomandimet e bëra nga BIRN, nuk japin përgjigje në vërejtjet tona. Pyetja është kush ka me qenë aksionar me rastin e shëndrrimit të OJQ-së në shoqëri aksionare. Me amendament thuhet se paratë e donatorëve do të i'u kthehen atyre, apo suficiti do të shpërndahet për

bamirësi, atëherë cili na qenka ai kapital që po mbetka për të blerë 25% aksione, nga vjen ky kapital që të iu ipet mundësia më ble 25% të aksioneve të bankës, në këtë mënyrë ne mendojmë që po shkelet ligji për liri të asocimit të OJQ-ve. Ne kemi kërkuar prej fillimit edhe si parti opozitare e kemi qëndrimin që të hiqet komplet kapitulli i mikrofinancave prej këtij ligji të trajtohet më një ligj të veçantë, në hartimin e të cilit duhet të marrin donatorët të cilet kanë kontribuar në ngritjen e sektorit të mikrofinancave, ekspertiza dhe kontributi edhe nga partitë opozitare. Siç e dijmë për FMN nuk është kusht rregullimi i sektorit të mikrofinancave, është kusht rregullimi i bankave apo sektorit bankar.

Xhevdet Neziraj, theksoi se qëndrimin i grupi parlamentar të AAK-së qëndron prapa qëndrimit që në këtë projektligj të ndahet pjesa e bankave prej pjesës mikrofinancave, në të kundërtën nuk do të përkrahet ky projektligj.

Gani Gërguri, njoftoi se projektligj ka filluar të punohet qysh në vitin 2010 dhe puna është filluar me FMN. Në fillim është filluar vetëm me ligjin për banka por meqenë se në atë kohë institucionet mikrofinanciare janë vlerësuar të jenë shumë pak të rregulluara e disa shumë të rritura me i tejkaluar edhe nivelin e institucioneve mikrofinanciare atëherë është iniciuar një procedurë në BQK lidhur me transformimin e tyre por çka projekti i tyre u konstatua që nuk kanë bazë në asnjë ligji edhe si rrjedhojë e asaj atëherë BQK-ja në bashkëpunim edhe me fondin monetar ka vendosur që krejt kredidhënësit institucionet që japin kredi të përfshihen në një legjislacion të përbashkët edhe për shkaqet e adresimit të çështjeve akute që ekzistojnë e jo vetëm të bankat por edhe të institucionet tjera kredidhënëse. Me FMN është gati krejt pjesa e ligjit për banka e kryer me ekspertizën e tyre. Ndërsa pjesa për mikrofinanca është bërë në bashkëpunim me ekspert të thesarit amerikan . Kështu ne e kemi finalizuar një draft të cilin pastaj e kemi këmbyer edhe me fondin monetar edhe me bankën botërore edhe me asociacionin e bankave komerciale në Kosovë edhe me asociacionin e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë. Dhe pastaj është finalizuar drafti dhe është dërgu të ministria sponzorese siç e kërkojnë procedurat. Problemi të institucionet mikrofinanciar është edhe i natyrës së keqkuptimeve psh ne në BQK pak çuditemi kur lexojmë në gazetë që janë ne pyetje 200 milion euro kapital. Institucionet mikrofinanciare bashkarisht janë 15 prej tyre 13 janë institucione mikrofinanciare OJQ, dhe kanë 95,96 milion euro ku përfshihen asetet e tyre jo kapitali i tyre. Dhe si rumbullakësim mund të them se këto 15 institucione i kanë 30 milion euro si kapital ku me i pjesëtuar secila i ka diku ka 2 milion kapital. Pjesa 65 milion le të themi janë obligime që këta i kanë ndaj tjetër kujt. Keto institucione nuk kanë shumë donacione keto i kanë vija kreditore më shumë dmth kanë marr para prej ofruesve të parave në tregun e parasë jashtë. Ideja e BQK-së ka qenë ta rregullon këtë sektor më mirë për shkak të asaj që duke marr hua jashtë keto institucione po e luajnë rolin një fare forme po iu ndihmojnë edhe bankave më mbajtë ndoshta kamatën e lartë.

Hykmete Bajrami, ritheksoi në këtë projektligj ligj thuhet se një institucion mikrofinanciar ka drejtë të 25% të aksioneve të një banke, por për me i ble 25% të aksioneve kemi than që implementohet neni 7 dhe neni 14. Neni 7 paragrafi 5 e lyp BQK-ja e kërkon vetë listën e aksionarëve. Pyetja jonë është kush kanë me qenë aksionarët, cila pjesë e kapitalit i'u kthehet donatorëve, si ka të drejtë donatori të me marr atë fond? Mandej nga po rrjedh kapitali që po blehet 25% të bankës, keto janë pyetjet që nuk kemi marr asnjëherë përgjigje?

Albana Fetoshi, theksoi se edhe ne si grupi parlamentar i lëvizjes vetëvendosje nuk e përkrahim këtë projektligj për shkak se nuk pajtohet që këto institucione mikrofinanciare OJQ-të të i'u jepet mundësia të shëndrrohen në banka. Lidhur me atë qfarë u tha se kapitali fillestar do të i'u kthehet donatorëve, pyetja është çka ndodh me kapitalin që ata e kanë akumuluar që disa vite? E vlerësojë presion që po bëhet nga jashtë në formë si po kërkohet të kalojë projektligji, do të duhej që mikrofinancat të ndahen nga ky projektligj dhe të rregullohen në forma tjera, ku do të përfshihen të gjithë akterët relevant.

Latif Gashi, falënderojë për kontributin që kanë dhënë të gjitha institucionet, në veçanti FMN dhe Thesarin Amerikan, për kontributin e madh që të rregullohet edhe ky sektor mikrofinanciar dhe të hyn në kuadër të sistemit bankar dhe gjithçka çka futet në Kosovë, të jetë e kontrolluar nga sistemi i BQK-së. Të gjithë kemi pasur dilema në fillim me projektligj, por besojë me amendamentet që kemi propozuar është rregulluar çështjet më të ndjeshme.

Merdian Kukleci, njoftoi se kornizë raportuese në Kosovë është korniza e standardeve nderkomtare të raportimit financiar ku obligohen çdo institucion financiar me raportuar, e atëherë me shumë vlen të bankat si kriter më rendësi për saktësinë e raportimeve financiare në këtë rast i ofrohet dhuruesit por nëse ka qenë grant më të gjitha kushtet e grantit pa asnjë kushtëzim sipas standardeve për grante atëherë dhuruesi nuk ka asnjë grant ose arsye më pranuar këtë grant sepse në fillim e ka dhurua si dhuratë ose grant për këtë shoqëri. Teprica e kapitalit do të jetë subjekt tatimi. Pasi të aprovet ligji institucionet mikrofinanciare i kanë tri alternativa e para është me vazhde qysh janë tu operu sot që nuk është ideale. Nëse nuk e lenë alternativë më paqë taksa e rregullon në kontekstin e financimit të operacioneve të sajë si institucion mikrofinanciar që dmth e rregullon qeshjen më kyçe siq është kostoja e financimit të cilën e paguan shtesa më e varfër e popullsisë së Kosovës. E dyta është që nëse vazhdon si institucion qysh është sot BQK-ja kërkon bord drejtues, drejtor ekzekutiv, komitete për menaxhimin e kreditor të likuiditetit operacional të gjitha rreziqeve tjera të cilat efektin e kanë në uljen e koston të financimit në Kosovë.

Hykmete Bajrami, OJQ-ja nuk ka pronar, dhe OJQ-ja ju takon të gjithë anëtarëve të asaj OJQ-je. Ne jemi kundër asaj që dikush të bëhet pronar me shëndrrimit e këtyre organizatave në shoqëri aksionare. Në jemi kundër asaj që me pas aksionar të një kapitali të OJQ-së, pasi që kjo bie në ndesh edhe me ligjin për lirin e asociimit të OJQ-ve.

Salih Asllanaj, pyeti përfaqësuesit e BQK-së a mjafton tatimi i suficitit të kapitali, kur dihet se ai kapital është krijuar në mënyrë të paligjshme. Mendimi im është që të konfiskohet i tërë kapitali që kanë krijuar këto organizata mikrofinanciare, që konsiderohet i paligjshëm.

Albana Fetoshi, pyeti përfaqësuesin e FMN-së a është i përfshirë Fondi Monetar Ndërkombëtar në këtë projektligj, a është kërkesë që të kalojë projektligji siq është duke përfshirë edhe institucionet mikrofinanciare apo qeveria po dëshiron që me këtë rast të i'u shmanget përgjegjësisë?

Jose Suleman, njoftoi sikur e përmendi edhe guvernatori për asistenten teknike që kemi ofruar gjatë gjithë kohës prej FMN-së. Profili i vet FMN-së në rastin e Kosovës është për tu përkujdesur që stabilitetin në pjesën e sektorit financiar dhe sektori fiskal është pjesa kyçe ku FMN-ja interesohet dhe arsyeja që është kaq i rëndësishëm ky ligj është fakti që edhe kriza që po mbretëron në botë ka ardhur prej si rrjedhojë në sektorin financiar andaj edhe për rregullimin e pjesës së sektorit financiar është pjesa e rëndësishme edhe e marrëveshjes tonë me qeverinë. Ne e kemi pas një mision këtu në Kosovë në fund të shkurtit deri në mars dhe ekzistojnë disa ndryshime se si fondi punon dhe dua të iu shpjegojë që bordi i FMN-së e ka caktuar datën me 27 prill për të diskutuar marrëveshjen me qeverinë e Kosovës. Dita e fundit e vizitës së misionit ka qenë në mars 05 stafi i FMN-së e ka një muaj afat për ta finalizuar raportin. Raporti është finalizuar javën e kaluar dhe është dorëzuar tek menagjmentit i FMN-së për diskutim. Gjatë kësaj jave ishte dashur me u finalizuar kjo prej shëfave të departamenteve dhe javën e ardhshme të dorëzohet tek menagjmentit i lartë. Pasi që menagjmentit e aprovon dokumenti duhet të ketë dy javë ditë mes njerëzve relevantë para se të diskutohet në bord. Më së largu 14 prill dokumenti duhet dorëzohet tek gjithë anëtarët e bordit.

Naser Osmani, theksoi se Ligji për Menaxhimin e Financave në Kosovë e rregullon qeshjen e financave, ligji për bankën qendrore e rregullon edhe bankën qendrore edhe bankave komerciale. Pyetja jem konkrete a mundemi t'i dërgojmë në likuidim OJQ mikrofinancat, likuidim të detyrueshëm?

Gani Gërguri, mënyra e licencimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare ka qenë e rregulluar me Rregulloret e UNMIK-ut që pjesa më e madhe e dispozitave janë pjesë e projektligjit. Ligji për BQK-në thotë se vetëm BQK e ka mandatin për të licencuar, rregullu edhe më mbikëqyrë qdo gjë që quhet institucion financiar e institucion. Piramida nuk mundet të ndërtohet sepse iu thash që ekziston baza rregullative prej 1999 dhe çka është përparësi për dallim nga shumë vende ne si BQK i kemi detyruar krejt institucionet mikrofinanciare t'i raportojnë kreditë në regjistrin qendror të kredive që është në BQK edhe duke i'u falenderu asaj kthimi i kredive edhe në institucione mikrofinanciare është i kënaqshëm.

Albana Fetoshi, theksoi se për FMN kërkesa është për dy ligje- Ligji për fondet pensionale dhe Ligji për bankat por jo edhe pjesa e institucioneve mikrofinanciare, prandaj këto institucione duhet të ndahen prej ligjit për bankat dhe të rregullon me ligj të veçantë.

Jose Suleman, ne jem duke folur për një ligj dhe marrëveshja mbështet komplet ligjin dhe nuk mundemi me nda ligjin.

Kryetarja, theksoi se kërkesa e nënkryetarit të parë të komisionit është që të mbeten amendamentet e komisionit funksional siç i janë propozuar. Me amendamentet e komisionit janë bërë ndryshime pozitive dhe po rregullohet një fushë e cila ka qenë shumë e parregulluar. Ne mundemi me dhënë një njoftim që e kemi mbajtur edhe një takim dhe shumica e anëtarëve qëndrojnë në amendamentet të cilat janë miratuar në komisionin për buxhet dhe financa. Raporti mbetet i njëjti dhe pa asnjë ndryshim. Qëndrojmë në ata çka është votuar në këtë komision.

Mbledhja përfundoi: 13:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona